

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zbardhet raporti i Von der Leyen, vlerëson Shqipërinë për mbylljen e tre kapitujve të parë negociues
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/zbardhet-raporti-i-von-der-leyen-vlereson-shqiperine-per-mbylljen-e-tre-kap-i585794
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 12:16:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 12:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	924321681d76506e190439609a6a9a03cdc0eab9b534c12801e41f0f01dd382f
TEKSTI	a35b83f1f1e3161d9977efcedaf293d395d569feb76b991527e04e362146afff
PAMJA	908dca59574fd10fb24296593aa1a4a4777c5b80452ab1f9ce8407f4857fb98c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e62410cc2907514ad1be3ab9d9f1385266632a905b7aa321fe2aa2fbe6da0a7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e62410cc2907514ad1be3ab9d9f1385266632a905b7aa321fe2aa2fbe6da0a7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Shtrenjtimi i natës mbush arken e shtetit, 18 mln euro më shumë ne vetem pesë muajNuti: Industria e mbrojtjes, prioritet strategjik për ShqipërinëNdryshon ligji për legalizimet, kushte për zonat fundit

Zbardhet raporti i Von der Leyen, vlerëson Shqipërinë për mbylljen e tre kapitujve të parë negociues

13 Shtator 2026, 14:20Bota TEMA



Zbardhet raporti i Von der Leyen, vlerëson Shqipërinë për

Presidentja e Komisionit Evropian Ursula Von Der Leyen do të publikojë të mërkurën raportin e saj vjetor për Evropën e Bashkuar. Në tekstin e zbardhur nga Klan News Von Der Leyen i ka rezervuar një pjesë të veçantë në fjalimin e saj zgjerimit të Bashkimit Evropian.

“Gjatë vitit të kaluar, negociatat e zgjerimit kanë marrë një vull të ri. Negociatat me partnerët e Ballkanit Perëndimor kanë përparuar në shkallë të ndryshme. Me më shumë se gjysmën e kapitujve negociues tashmë të mbyllur, Mali i Zi është veçuar si shteti më i avancuar në procesin e tij të anëtarësimit. Edhe Shqipëria arriti një moment kyç të rëndësishëm kur mbylli tre kapitujt e parë negociues në muajin korrik”, tha Von Der Leyen.

Në këtë pjesë të raportit që do të lexohet të hënën në parlamentin Evropian nga Von Der Leyen zgjerimi konsiderohet si projekti më i suksesshëm i Bashkimit Evropian dhe një domosdoshmëri strategjike.

“Në një botë më të rrezikshme dhe të fragmentuar, siguria e Evropës varet nga stabiliteti i fqinjësisë së saj. Kjo fillon me politikën tone të zgjerimit. Ky ka qenë projekti më i suksesshëm i Bashkimit tonë dhe sot është një domosdoshmëri strategjike. Popujt e Ballkanit Perëndimor, Ukrainës, Moldavisë dhe Gjeorgjisë e kanë bërë të qartë se e shohin të ardhmen e tyre si pjesë e Bashkimit Evropian. Ndonëse zgjerimi do të mbetet gjithmonë një proces i bazuar në merita, shumë vende, përfshirë Ukrainën e goditur nga lufta, i kanë përmbushur angazhimet e tyre dhe meritojnë të ecin përpara. Ne jemi të vendosur t’u japim atyre mbështetjen tonë të plotë në rrugën drejt anëtarësimit”, tha Von Der Leyen.

Von Der Leyen iu referua edhe planit të rritjes.

“Krahas negociatave, ne po udhëheqim investimet dhe reformat përmes planeve të dedikuara për reformën dhe rritjen. Ne po forcojmë tashmë lidhjet dhe po integrojmë vendet kandidate në Tregun tonë të Përbashkët, po lidhim sistemet energjetike, po investojmë në rrjete dhe po forcojmë lidhjet e transportit, dhe ne po e forcojmë bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes”, tha Von Der Leyen.

Ajo nënvizon edhe integrimin gradual.

“Për të tretin vit radhazi, Raporti për Sundimin e Ligjit ka përfshirë gjithashtu një vlerësim për Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, duke i integruar ato më tej në mekanizmat tanë të BE-së. Për më tepër, Shqipëria, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë pjesë e Zonës së Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) dhe më 1 janar të këtij viti, Moldavia dhe Ukraina iu bashkuan zonës sonë të roaming-ut. Këshilli tashmë i ka dhënë Komisionit mandatin për të negociuar marrëveshje të ngjashme me gjashtë partnerët e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që njerëzit që udhëtojnë mes BE-së dhe rajonit të mund të përdorin shërbimet celulare me tarifë e vendit të tyre (roaming si në shtëpi)”, tha Von Der Leyen.

Më 30 shtator KE do të publikojë propozimet për thjeshtëzimin e procesit të integritimit ku përfshihen integrimi gradual dhe heqja e votimit me unanimitet që është bërë pengesë në vite për Shqipërinë dhe shtetet e tjera kandidate.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Goditet një pikë karburanti pranë kufirit me Poloninë, ministri ukrainas: Terrori i Putinit po troket në dyert e BE dhe NATO-s](#)

13:30 Bota

[Adoleshenti dyshohet se planifikonte sulm në shkollë, bisedat me ChatGPT alarmojnë autoritetet](#)

13:20 Bota

[Tri humbje dhe më afër fitores se kurrë: Pse 2027 mund të jetë viti i Marine Le Pen](#)

13:10 Bota / 1 koment

[A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte të përjetshme me Iranin?](#)

12:40 Bota / 1 koment

[Obama ngre alarmin për inteligjencën artificiale: Mund të bëhet e rrezikshme nëse nuk e marrim nën kontroll](#)

12:30 Bota / 2 komente

[Putin çon reliket e princit luftëtar në front, Kremli kërkon “mbrojtje hyjnore” për ushtarët rusë](#)

12:20 Bota / 1 koment

[Irani zbut tonet me Riadin, Pezeshkian: Nuk jemi në luftë me Arabinë Saudite](#)

12:10 Bota / 1 koment

[Mes tensioneve me SHBA-në, Kanadaja i drejtohet Evropës për të forcuar lidhjet](#)

11:10 Bota

[Kongo përballet me shpërthimin më të rëndë të Ebolës, mbi 7 mijë raste dhe afro 4 mijë viktima](#)

09:40 Bota

[Ukraina përgatitet për një dimër të ashpër ndërsa sulmet ruse godasin ekonominë](#)

09:30 Bota

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Unë jam me Petrit Malajn](#)

14:45 Blog / 60 komente

[‘Det’ pjesëmarrësish në ‘Marshin për liri’ në Prishtinë: ...](#)

15:15 Rajoni / 74 komente

[BE reagon para vendimit për Thačin dhe ish-krerët e UÇK-s...](#)

14:30 Rajoni / 33 komente

[John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?](#)

11:40 Blog / 20 komente

[VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...](#)

10:02 Politika / 7 komente

Blog Tema

[Shënime nga Konventa e Teksasit në ShBA](#)

12:00 Blog / 13 komente

[EuReporter artikull për kryebashkiakun, Veliq deklaron: "Ende nuk e kam humbur shpresën"](#)

10:30 Blog / 7 komente

[Demokracia jonë pa hardware dhe software?!](#)

08:23 Blog / 7 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)

- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.